



- ▶ NDIHMOHEN FAMILJET QË JETOJNË NË RRETHANA TË VËSHTIRA SHOQËRORE.....1
- ▶ FILLOI PUNËN GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PËRSHKRIMIT TË VENDEVE TË PUNËS PËR ZYRAT KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....2
- ▶ TERRENI I SPORTIT - NJË PROJEKT QË BASHKON RININË MULTIETNIKE.....2
- ▶ ZÇK MERR PJESË NË HARTIMIN E KRITEREVE PËR PROGRAMIN PËR RIATDHESIM.....2



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Zyra e Kryeministrit – Kancelarija premijera –Office of the Prime Minister
 Zyra për Çështje të Komuniteteve / Kancelarija za pitanje zajednica / Office for Community Affairs

Fuqia në diversitet

NDIHMOHEN FAMILJET QË JETOJNË NË RRETHANA TË VËSHTIRA SHOQËRORE

Zyra për Çështje të Komuniteteve financoi ndërtimin e shtëpive për tri familje të komuniteteve jo-shumicë në Graçanicë, Podujevë dhe Ferizaj



SHTËPIA NË PODOJEVË



SHTËPIA SI KA QENË MË PARË



SHTËPIA NË GRAÇANICË



SHTËPIA NË FERIZAJ

Ndërkaq familja shtatë anëtarëshe e z. Berisha, i cili jeton me nënën, bashkëshorten dhe katër fëmijë, është përfitues i shtëpisë në sipërfaqe prej 75 metër katrorë të ndërtuar në Ferizaj.

Kryefamiljari i kësaj shtëpie Bekim Berisha falënderoi institucionet e Qeverisë së Kosovës për krijimin e kushteve të strehimit për familjen e tij, e cila në mungesë të kushteve elementare ekonomiko-sociale, prej vitesh kishte jetuar në një shtëpi me rrezik shembjeje.

Familja shtatë anëtarëshe nga radhët e komunitetit ashkali, që deri më tani kishte jetuar në një shtëpi pothuajse të rrënuar në Podujevë, në mungesë të ujit dhe higjienës totale, tashmë u vendos në shtëpinë e re të ndërtuar. Shtëpia ka një sipërfaqe prej 75 metër katrorë dhe përmbush standardet e nevojshme për strehimin e pjesëtarëve të kësaj familjeje.

Gjatë një vizite që i bëri këtyre familjeve këshilltari i lartë i Kryeministrit dhe drejtori i ZÇK-së, z. Srdjan Sentic, në emër të Kryeministrit Taçi duke i përgëzuar familjet për vendosjen në shtëpitë e reja theksoi se krijimi i kushteve minimale, por që janë standarde për një jetë më të mirë për qytetarët, e në veçanti për familjet që jetojnë në rrethana të vështira shoqërore, është i një rëndësie jetike që do vëmendje përherë. Familjarëve të këtyre tri familjeve ju dëshiroi një jetë me plotë begati e shëndet.

Tri familje të pastrehë nga radhët e komunitetit serb dhe ashkali, që prej vitesh jetuan në kushte tejet të vështira ekonomike dhe sociale, falë gatishmërisë së Zyrës për Çështje të Komuniteteve tashmë e kanë të zgjidhur problemin e banimit. Kjo u realizua si rrjedhojë e parashtrimit të kërkesës për ndihmë nga këto familje dhe pas identifikimit të gjendjes së mjerueshme në të cilën jetonin pjesëtarë e këtyre familjeve. Këto shtëpi janë ndërtuar në përputhje me standardet që përmbushin nevojat e familjarëve.

Familja prej pesë anëtarësh e z. Simjonovic këtë dimër do ta kalojë në shtëpinë e sapo ndërtuar në Graçanicë. Kjo shtëpi ka 62 metër katrorë dhe ka dy dhoma, një kuzhinë dhe një banjë.

Kryefamiljari i kësaj shtëpie i cili jeton me bashkëshorten, dy vajzat dhe djalin, falënderoi ZÇK-në për ndihmën në ndërtimin e shtëpisë së tij. Ai theksoi se familja e tij është mjaft e kënaqur me standardet e ndërtimit të shtëpisë, por me vetë dëshirë kanë bërë disa investime të vogla që të harmonizojë nevojat familjare.

TERRENI I SPORTIT-NJË PROJEKT QË BASHKON RININË MULTIETNIKE

Projekti për të cilin u bë pranim-dorëzimi këto ditë, dëshmon edhe njëherë përkushtimin e ZÇK-së për të ndihmuar komunat e reja në promovimin e sportit dhe rekreacionit



Të rinjtë e komunës së Graçanicës tashmë kanë mundësi të zhvillojnë aktivitete të ndryshme sportive në terrenin sportiv që është funksional në fshatin Kishnicë të komunës së Graçanicës. Ky projekt i financuar nga

Zyra për Çështje të Komuniteteve dhe partnerët, u realizua me qëllim që të rinjtë të kësaj zone t'u ofrohen mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive, e në veçanti nxënësve të shkollës së Kishnicës.

Aktivitete të këtilla do të përkrahen edhe në të ardhmen, në mënyrë që krahas artit dhe kulturës edhe zhvillimi i aktiviteteve sportive të përbashkëta krijojnë mundësinë e të qenit së bashku dhe të shoqërizimit të njerëzve pavarësisht përkatësisë etnike, të cilët japin një kontribut shumë të rëndësishëm për dialog duke krijuar një ardhmëri më të mirë për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë.



FILLOI PUNËN GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PËRSHKRIMIT TË VENDEVE TË PUNËS PËR ZYRAT KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM



Pas miratimit të Rregullores për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) dhe reformimit të bërë në përputhje me legjislacionin e ri, filloi punën Grupi Punues për përshkrimin e vendeve të punës të zyrtarëve të ZKKK.

Grupi punues përbëhet nga anëtarë të ministrive dhe organizatave ndërkombëtare në cilësinë e vëzhguesve. Ky grup kryesohet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, përdërisa Zyra për Çështje të Komuniteteve ka rolin e zëvendës-kryesuesit.

Qëllimi i hartimit të përshkrimit të vendeve të punës është unifikimi i të gjitha posteve të punës në nivelin lokal, përkatësisht zyrat komunale për komunitete në gjithë Kosovën. Përveç tjerash, ZÇK hartoi edhe Planin e Punës për veprimet e mëtutjeshme dhe kompletimin e bazës ligjore, si dhe ngritjen e kapaciteteve të këtyre zyrave.



ZÇK MERR PJESË NË HARTIMIN E KRITEREVE PËR PROGRAMIN PËR RIATHDESIM

Zyrtarë nga Zyra për Çështje të Komuniteteve janë pjesë e grupit punues për hartimin e kriterëve për shfrytëzimin e fondit për riintegrimin e personave të riadhesuar. Bartëse e kësaj nisme është Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa ZÇK në këtë grup punues adreson komente të cilat kanë ndikim në komunitetet dhe riintegrimin e tyre.